



3D-IMP-ACT

Interreg - IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro



3D-IMP-ACT

APOLONIA PËRMES ARTIT DHE TEKNOLOGJISË

APOLLONIA THROUGH ART AND TECHNOLOGY



pnn
PARKU
ARKEOLOGJIK
APOLONI



mn
MUZEU
ARKEOLOGJIK
APOLONI

Ky botim, i shtypur në 2000 kopje, nuk është në shitje. Iu shpërndahet falas të gjithë të interesuarve që vizitojnë Muzeun Arkeologjik Apolloni deri në përfundim të rezervave.

Fotografitë e publikuara në këtë botim janë origjinale dhe të realizuara nga institucionet e përfshira në projektin 3D-IMP-ACT, si dhe institucionet mbështetëse të projektit që kanë kontribuar në përgatitjen e këtij botimi.

Mbështetja financiare për hartimin dhe publikimin e këtij materiali është siguruar nga Programi Interreg IPA CBC, Itali - Shqipëri - Mal i Zi 2014/2020.

The publication printed in 2000 copies, is not intended for sale. It shall be distributed free of charge to all interested visitors of the Archaeological Museum of Apollonia until the number of copies available finish.

The pictures published in this publication are original and are realized from partner institutions of 3D-IMP-ACT project and stakeholder institutions that have contributed to the realization of this publication.

The preparation and printing of this publication was made possible with the financial support of Interreg IPA CBC Italy-Albania-Montenegro 2014/2020 Program.

The authors are responsible for the choice and the presentation of the facts contained in this material and do not commit the Program. The designations employed and the presentation of material throughout this brochure do not implement the expression of any opinion whatsoever on the part of this Program concerning the legal status of any country, territory, city or area, and its authorities, or concerning the delimitations of its frontiers or boundaries.

Projekti 3D-IMP-ACT

Projekti 3D-IMP-ACT “Virtual reality and 3D experiences to IMProve territorial Attractiveness, Cultural heritage smart management and Touristic development”, bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit Interreg IPA CBC, Itali - Shqipëri - Mal i Zi 2014/2020.

Periudha e realizimit: 2018-2020

Partnerë: Politecnico di Bari, IT (Partner Lider), Polo Museale della Puglia (IT), Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (AL), Universiteti Politeknik i Tiranës (AL), Univerziteti Crne Gore Podgorica (ME).

Faqe Web: 3dimpact.italy-albania-montenegro.eu

Ky projekt, synon promovimin dhe vlerësimin e trashëgiminë natyrore dhe kulturore ndërmjet shteteve partnere Itali-Shqipëri-Mal i Zi, në një mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse që ndikon në mbrojtjen dhe cilësinë e mjedisit si bazë për çdo lloj promovimi turistik. Projekti gjithashtu synon krijimin e produkteve digjitale, modelet 3D VR/AR dhe ture, artefakte makete 3D të printuara të objekteve, rrjete “virtuale” që lidhin sitet e trashëgimisë kulturore të përzgjedhura nëpërmjet platformës WebGIS.

Rezultatet e 3D-IMP-ACT në Shqipëri:

Projekti 3D-IMP-ACT ka mundur krijimin e një platforme online për lidhjen e të gjitha siteve të përzgjedhura si raste studimore të projektit në të tre shtetet partnere. Platforma <https://3dimpact.poliba.it/lm/index.php/view/map/?repository=3dimpact&project=map>, ofron modelet digjitale të siteve, ture virtuale si dhe informacion të detajuar mbi to. Parku arkeologjik Apoloni, Kalaja e Bashtovës, Kalaja e Peqinit janë ndër rastet studimore në Shqipëri të cilat janë pjesë e platformës. Projekti ka mundur gjithashtu krijimin e tre laboratoreve për përdorimin e teknologjive 3D, njëri prej

3D-IMP-ACT project

The 3D-IMP-ACT project “Virtual reality and 3D experiences to IMProve territorial Attractiveness, Cultural heritage smart management and Touristic development”, is co-financed by the European Union in the framework of the Interreg IPA CBC Program, Italy - Albania - Montenegro 2014/2020.

Realization period: 2018-2020

Partnership: Politecnico di Bari, IT (Lead Partner), Polo Museale della Puglia (IT), National Institute of Cultural Heritage (AL), Polytechnic University of Tirana (AL), Crne Gore Podgorica University (ME).

Website: 3dimpact.italy-albania-montenegro.eu

This project aims to promote and evaluate the natural and cultural heritage between the partner countries Italy-Albania-Montenegro, in a systematic and comprehensive way that affects the protection and quality of the environment as a basis for any type of tourism promotion. The project also aims to create digital products, 3D VR / AR models and tours, 3D printed artefacts or objects, “virtual” networks linking selected cultural heritage sites through the Web-GIS based mapping of historic sites and territorial networks.

Results of 3D-IMP-ACT in Albania

3D-IMP-ACT project has enabled the creation of a Web-Gis platform for linking all selected pilot case studies from the three partner countries. The platform <https://3dimpact.poliba.it/lm/index.php/view/map/?repository=3dimpact&project=map>, offers

Web-GIS based mapping of historic sites and territorial networks, digital site models, photorealistic 3D documentation of pilot-cases, Virtual/Augmented reality models and 3D environments of historic sites and detailed information on

të cilëve është instaluar pranë zyrave të IKTK-së. Produkte të tjera të projektit janë materiale informuese dhe promovuese, aktivitete dhe workshop-e për informimin dhe përfshirjen e moshave të reja, skanim dhe printim 3D i modeleve digjitale të objekteve të trashëgimisë etj.

Në emër të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), dhe në cilësinë e Menaxherit të projektit 3D-IMP-ACT për IKTK-në, dëshiroj të falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët dhe partnerët që kanë kontribuar në këtë projekt, si dhe në hartimin e kësaj broshure të munguar mbi promovimin e koleksionit të Muzeut Arkeologjik Apoloni, në veçanti:

Zyrën e Administrim Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni – Bylis, Muzeun Arkeologjik të Apolonisë, Universitetin Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, Muzeun Historik Kombëtar, komunitetin lokal që kanë qenë të interesuar dhe kanë marrë pjesë aktive në gjithë aktivitetet e realizuara pranë Parkut Arkeologjik të Apolonisë në kuadër të projektit 3D-IMP-ACT.

Një falenderim i veçantë i dedikohet programit të financimit të këtij projekti, Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi 2014-2020, nëpërmjet të cilit u bë i mundur realizimi i këtij publikimi, në funksion të qëllimit të përbashkët, mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë tonë kulturore materiale.

Arta Dollani

Drejtor i Përgjithshëm
Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

them. The archaeological Park of Apolonia, Castle of Bashtova, Castle of Peqin are among the selected case studies in Albania which are part of the platform. The project has also enabled the establishment of three laboratories for the use of 3D and digital technologies, one of which has been installed in IKTK premises. Informative and promotional materials, activities and workshops aimed at informing and involving young people, 3D scanning and printing of digital models of heritage objects are among the other products of the project.

On behalf of the National Institute of Cultural Heritage (IKTK), and as the Project Manager of 3D-IMP-ACT for IKTK, I would like to thank all the collaborators and partners who have contributed to this project, as well as to the design of this missing publication for the promotion of the collection of the Apolonia Archaeological Museum, in particular:

The Office of Coordination and Administration of the Archaeological Park Apolonia - Bylis, Museum of Apollonia, Polytechnic University of Tirana - Faculty of Mechanical Engineering, National Historical Museum, the local community who have shown high interest and have actively participated in all activities carried out in the Archaeological Park of Apolonia in the framework of 3D-IMP-ACT project.

Special thanks goes to the financing program of this project, Interreg IPA CBC Italy-Albania-Montenegro 2014-2020, through which the realization of this publication was made possible in view of the common goal, protection and promotion of our tangible cultural heritage.

Arta Dollani

Director General
National Institute for Cultural Heritage

Muzeu Arkeologjik Apoloni



Muzeu Arkeologjik Apoloni (MAA) është një ndër muzetë më të mëdhenj arkeologjik të Shqipërisë. Muzeu është i vendosur në një manastir mesjetar të fundit të shek. XII, i cili në vetvete është një kompleks muzeal mes objekteve dhe monumenteve.

MAA përbën një nga arteriet më të rëndësishme të Parkut Arkeologjik Kombëtar Apollonia, jo vetëm për vizitorët, por edhe për studiuesit e arkeologjisë.

Ky muze u hap për herë të parë në vitin 1957. MAA rikonceptohet nën drejtimin e Institutit Arkeologjik në vitet 1971 dhe 1985 për të sjellë historinë e qytetit antik në një linjë kronologjike nëpërmjet objekteve arkeologjike të ekspozuara.

Muzeu Arkeologjik mbyllet gjatë vitit 1991 dhe do të rihapet më pas duke u rikonstruktuar me fondet e UNESCO-s dhe qeverisë spanjolle.

Objektet e këtij muzeu janë të ekspozuara kronologjikisht, ku janë rreth 1000 objekte origjinale. Ato ndër më përfaqësueset, sipas tipologjive tregojnë historinë e Apolonisë nga prehistoria deri në rënien e qytetit dhe braktisjen e tij.

Vizita në ambientet muzeale fillon nga periudha parakoloniale duke përfshirë periudhat e Paleolitit të Lartë, Neolitit, Bronzit dhe Hekurit. Më pas vizitori njihet me periudhën Arkaikë, e cila korrespondon me themelimin e qytetit antik të Apolonisë. Ambientet në vijim përmbajnë objekte të Periudhës Klasike (shek. V-IV p.K.), Periudhës Helenistike (shek. III-I p.K.) dhe përfundon me Periudhën Romake (shek. I-IV m.K.) deri në fund të jetës së qytetit në shek. V m.K..

Ornela Durmishaj

Drejtor

Zyra e Administrim Koordinimit
të Parkut Arkeologjik Apoloni-Bylis

Archaeological Museum Apollonia



The Archaeological Museum Apollonia (AMA) is one of the biggest Archaeological Museums of Albania. The Museum is set inside the Medieval Monastery of late 12th century, which itself is a museal complex among objects and monuments.

AMA is of great importance in the National Archaeological Park of Apollonia, not only for the tourists as visitors but also for the Archaeology Researchers.

The Museum was established in 1957. Later in 1971 and 1985 the way of displaying the objects was reconceived with the intention of telling through the findings the history of city in a chronological line.

The Archaeological Museum got closed in 1991 and got reopen soon after a reconstruction period, funded by UNESCO and Spanish Government.

The objects are chronologically displayed and among them around 1000 are original. There also the most representative ones, which according to their typology tell the Apollonia's history from the Prehistoric times to the city's declining period and its abandonment.


Visiting the Museum begin with the exhibitions of the area findings since pre-Colonial periods (Upper Paleolithic, Neolithic, Bronze and Iron ages). Later the visitor gets to know city's Archaic Period, which consist to the founding time of the city. The other spaces offer to see objects dated to Classical Period (5th-4th century B.C.), Hellenistic Period (3rd-1st century B.C.), Roman Period (I-IV A.D.) till the end of city's life in the 5th century A.D..

Ornela Durmishaj

Director

Administration and Coordination office
of the Archaeological Park Apollonia-Bylis

Koleksioni i Muzeut Arkeologjik Apoloni



Archaeological Museum Collection Apollonia

STATUJË E APOLONIT PITIK

Periudha Romake, shek. II m.K.. Mermer.

Apoloni është Perëndia e diellit dhe paraqitet edhe si mbrojtësi i kafshëve e i arteve, emrin e të cilit ka edhe qyteti antik i Apolonisë. Ai është vendosur në krah të një tripodi (trekëmbëshi), i cili përreth është i mbështjellë nga një gjarpër dhe mbi të është vendosur zhgualli i një breshke, përdorur si instrument muzikor (harpa e Apolonit).

APOLLO, GOD OF THE SUN, MUSIC, ARTS, ARCHERY AND THE PROPHECY

Roman Period, 2nd century A.D.. Marble.

Apollo is represented with Delphic tripod, the Python and the Tortoise that represents the symbol of the music where the lyra was fixed.

STATUJË MATRONE (ZONJË ARISTOKRATE)

Periudha Romake, shek. II m.K.. Mermer.

Në antikitet aristokracia e qytetit kishte mundësi financiare të porosishte një statujë ku figurohej një pjesëtar i familjes. Apollonia, si shumë qytete antike kishte atelienë e saj të punimit të statujave. Këto atelie prodhonin vetëm trupin, ndërsa vendi ku do vendosej koka lihej bosh. Kjo bëhej për arsye se koka do bëhej më vonë me një mermer më cilësor dhe më pas do të vendosej në trupin e bërë më herët. Pasi vendosej koka bëhej pikturimi i statujës, që t'i ngjante sa më shumë personit që i ishte dedikuar.

MATRON, STATUE OF THE LADY OF THE HOUSE WITH ARISTOCRATIC STATUS

Roman Period, 2nd century A.D.. Marble.

In the left hand is houlding a pyxis (vase for perfume) while from the missing head is clear that the statue is worked in two separated pieces, so the head could be placed in a later moment or could be changed.

STELË VARRI. ZBRITJA NË HADES (BOTËN E TË VDEKURVE)

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Gur gëlqeror.

Zbritja në Hades është një prej rasteve të rralla të paraqitjes së këtyre skenave në art. Skena përshkruan zbritjen e të vdekurit në botën e nëndheshme. Në hyrje të shpellës janë dy sirena vajtuese dhe dy femra duke i dhënë lamtumirën të ndjerit. I ndjeri ndihmohet nga Hermes Psikopompos që të zbresë në varkën e Kerontit (varkëtarit), i cili e kalon në anën tjetër të lumit. Në hyrje të Hadesit e pret Minesi (gjykatësi i shpirtrave), i cili vendoste nëse do ta lejonte ose jo të hynte. Apolonia ishte e njohur për prodhimin e këtyre llojeve të stelave.

FUNERARY STELE. THE DESCENT INTO HADES

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Limestone.

It represents completely the descent into the under world, from the upper part the crying ladies, the dead man stepping down the stairs which is helped by Hermes Psychopompos to the Karon boat crossing Stiks river. The stele is decorated with floreal and different architectonical elements.



STELË VARRI

Periudha Romake, shek. II m.K.. Gur gëlqeror.


Stela përmban një mbishkrim në latinisht, që i dedikohet Cecilias: “*E bukura Cecilia, e bija e Luciusit nga Bylisi, gruaja* (bashkëshortja) *e Lartidit nga Naisus* (Nishi i sotëm). *Ajo prehet këtu* (ka qenë vendosur mbi varrin e saj). *Jetuan të martuar së bashku për 42 vjet. Në një martesë të lumtur dhe pa u grindur asnjëherë.*”

FUNERARY STELE, TOMB STONE

Roman Period, 2nd century A.D.. Limestone.

The latin inscription is dedicated to the beautiful Cecilia and her man Lartidio that lived 42 years together married and happy.





GUR MILIAR (KILOMETRIK)

Periudha Romake, fillimi i shek. III m.K.. Gur gëlqeror.

Gur kilometrik me mbishkrim latin i ekspozuar në portikun e muzeut të Apolonisë. Mbi të vendosej distanca e rrugës. Përkon me kohën e perandorit Karakalla. Ky gur ka qenë vendosur në një segment kryesor të Rrugës Egnatia, pranë Apolonisë. Mbishkrimi në latinisht: IMP CAES (Imperator Kaizar) M (Markus) AVRELIUS ANTONINUS – PIUS – FELIX – AVGVSTVS – PARTHICVS MAXIMVS – BRITANICVS MAXIMVS – GERMANICVS MAXIMVS – PONTIFEX MAXIMVS – TRIBUNICIAE POTESTA XX – IMP (Imperator) III. COS (Konsul) IIII – PP (Pater Patria) – PROCOS (Prokonsul). RESTITUIT.

MILESTONE

Roman Period, the beginning of 3rd Century A.D.. Limestone.

The object indicates the distance on the road way. The latin inscription indicates the contribute of the emperor Caracalla on the maintenance of the Roman route Via Egnatia, the south trace of it initiating from Apollonia. Into the inscription is described the attributions and the titles that Markus Aurelius Antoninus held in lifetime (see above).



GRUA NË FORMËN E VIOLINËS

Mijëvjeçari i II-të p.K.. Terrakotë.

Përfaqëson Magna Mater (Nëna e madhe). Figurinë femërore të sheshtë “në formë violine”, me gjoks të ngritur dhe me krahë, tip shumë i përhapur në kulturat e Neolitit të Vonë, ku kemi dhe një kopje në nekropolin e Apolonisë. Autorët antikë na japin informacione se para ardhjes së kolonëve helenë nga Korinti, zona ishte e banuar nga Ilirët e fisit të Taulantëve.

TERRACOTTA FIGURINE

3rd millennium B.C. Terracotta.

Violin shaped female is representing the mother god. Found in the necropolis of Apollonia, this figurine is typically presented in the West Balkans end Aegean area in the Neolithic and Bronze Age.

KOTILE

Periudha Arkaike, fundi i shek. VII p.K.. Qeramikë.

Kotile është një kupë vere me dy vegje horizontale, grykë të gjerë dhe fund të sheshtë, që përdorej gjatë banketeve të një aristokrati. Ena është e dekoruar me motive zoomorfe dhe floreale, ku ndër motivet më të përdorura në të janë mjelma dhe pantera, si dhe gjethe bimësh e disa linja horizontale e vertikale. Vera, e cila konsiderohej nektari i Perëndive duhet të kishte edhe një kupë të përshtatshme për këtë pije. Ena është një import korintik, e gjetur në Apoloni.

COTYLE, DRINKING CUP DECORATED WITH BLACK FIGURES

Archaic Period, end of 7th Century B.C.. Pottery.

The main decoration is the panther and the swan while in the top and bottom there are geometric decorations, triangles, circles and segment lines. The object is imported from Corinth and found in Apollonia.



LEKIT ME FIGURA TË ZEZA

Periudha Arkaike, shek. VI p.K.. Qeramikë.

Lekitet janë enë që shërbenin për ruajtjen e verës, vajit, parfumeve etj., këtu importe atikase, të gjetura në Apoloni. Ato kanë formën e shisheve me vegje, me grykë të ngushtë dhe fund unazor. Lekitet janë të pikturuara me figura të zeza si dhe paraqesin skena të cilat janë të larmishme si: skena kalorësish, skena dionisiake (skena festash), skena luftimi nga heronjtë e mitologjisë, skena floreale (bimore) etj.. Këto enë i gjejmë kryesisht gjatë gjermimeve në varre, ku vendoseshin si pjesë e objekteve që merrte i vdekuri në botën e përtejme.

LEKITHOS WITH BLACK FIGURES

Archaic Period, second half of 6th Century B.C.. Pottery.

It is decorated with Dionisiac and floreal motifs. The lekithos are used to keep oil, parfum etc..





FIBULA BRONZI

Shek. III p.K. – shek. II m.K.. Bronz.

Fibula është një element kryesor i veshjes në antikitet, i punuar zakonisht prej metali (bronz, argjend, ar, hekur) ose fildish. Ka edhe fibula të punuara me gurë të çmuar ose me shumë zbukurime. Ky lloj objekti është përdorur për të kapur skajet e një veshje. Fibulat e para paraqiten në epokën e Bronzit në tumat Ilire dhe përfaqësojnë një tip unik. Fibulat kishin për qëllim kryesisht kapjen e veshjeve, ku roli i tyre ishte si karfica zbukuruese, ku “koka” e fibulës, “harku” ose “trupi” shfaqnin dekorimet më të hollësishme. Në disa kultura këto lloj dekorimesh mund të kishin referenca simbolike.

BRONZE FIBULA

3rd Century B.C. – 2nd Century A.D., Bronze.

Fibula are clasps for clothing, used in antiquity. These objects are found in various metals and material. The fibulae had various decorative shapes such as volutes, boat shapes, bows, etc. and were often decorated with motifs engraved on the body.

ENË NË MINIATURË

Shek. VI p.K.. Qeramikë.

Këto lloj enësh përdoreshin në antikitet si dhurata votive për tempujt kushtuar Perëndive të ndryshme dhe vendoseshin brenda në varre si objekte që do t'bi përdorte i vdekuri në jetën e përtejme. Për këtë arsye filluan t'i bënin gjithmonë e më të vogla, pasi këto enë nuk ishin funksionale por simbolike dhe nuk zinin shumë vend në tempuj, sikurse në varre.

VOTIVE OBJECTS IN MINIATURE

6th Century B.C.. Pottery.

These are the imitation of the normal size used vessels. Generally, they were dedicated to the Gods in the temples or placed into the graves for the dead.

ENË PARFUMI

Shek. V p.K.. Alabastron.

Këto enë quhen alabastron dhe kanë formën e amforave në miniaturë ose flakone.

Ato pikturohen me ngjyrë blu dhe vijat bojëqielli të çelur dhe përdoreshin për mbajtjen e parfumeve. Këto cilësoheshin si objekte luksi dhe importoheshin nga disa territore të largëta të njohura për prodhimin e tyre. Në këtë rast kemi importe fenikase, nga Afrika e veriut.

ALABASTRON, MINIATURISTIC VASES USED FOR THE PERFUME

5th century B.C.. Alabastron.

The material is opack blue colored glass decorated with yellow stripes, the shape is imitation of the transport amphoras.



GARUZHDE BRONZI PËR TË SHËRBYER VERËN

Shek. IV p.K.. Bronz.

Këto objekte janë gjetur gjatë gërmimeve në nekropolin (varrezat antike) e Apolonisë. Ato përdoreshin për të shërbyer verën nëpër kupat e ndryshme (kilik, skifos, etj.). Dekorimi i tyre me kokën e Mjelmës tregon se këto përdoreshin nëpër evente ku të gjithë mund të shihnin rëndësinë e familjes që i kishte, duke treguar edhe statusin social nëpërmjet këtyre objekteve.

BRONZE LADLETS

4th Century B.C. Bronze.

These ladlets are found in the necropolis of Apollonia. In antiquity were also used to fill wine cups. The handles are decorated with various motifs, such floral and zoomorphic figures.





KOTON

Periudha Arkaike, shek. VI p.K.. Qeramikë.

Kotone të shekullit VI p.K., janë enë qeramike, të cilat shërbenin për të kulluar verën. Ato kanë formë të rrumbullakët dhe buzët e përveshura nga brenda deri afër fundit. Përgjithësisht fundi është i sheshtë, por në disa raste të rralla kemi dhe fund unazor. Kotonët e tipit jonik kanë ngjyrë të kuqerremtë.

KOTHON

Archaic Period, 6th Century B.C.. Pottery.

Kothon, decorated with different geometrical motifs in black color. This type of vessel is used on the filtration of wine and perfumes. The lips are turned inwards because of their function to hold in the impurities.



OLPE E PIKTURUAR ME BREZA

Periudha Arkaike, shek. VII p.K., mes viteve 630-610. Qeramikë.

Kjo enë shërbente për të servitur verën gjatë ceremonive festive dhe lidhet me themelimin e qytetit antik të Apolonisë nga kolonët e parë që vinin nga Korinti. Ajo është gjetur gjatë gërmimeve në nekropolin e Apolonisë. Olpe me këtë lloj dekori nuk i gjejmë të shpeshta nëpër site të tjera të Mesdheut. Figurat dekorative të Olpes janë krijesat mitologjike, ekzotike dhe floreale. Modeli i Sfinksit nuk ngjason me atë Egjiptian, por me atë që përdorej nga Akamenidët (Perandoria Persiane). Ena është import korintik.

OLPE, PAINTED WITH BLACK FIGURES

Archaic Period, end of 7th Century B.C.. Pottery.

Olpe is used to serve the wine in festive ceremonies. It is decorated in four rows with mythological and zoomorphic figures.

ARTEMISA

Periudha Romake, shek. II m.K.. Mermer.

Artemisa ka qënë një nga Perënditë më të respektuara në antikitet, pothuajse në gjithë pellgun e Mesdheut, sikurse gjithashtu dhe në Ilirinë antike. Ajo paraqitet e veshur me tunikën deri mbi gjunjë, e armatosur me harkun e shigjetat dhe gjithmonë në pozicion vrapimi.

Atë e shoqëronin disa kafshë si: qeni, dreri, lepu, ariu, pantera etj.. Pemët e shenjta të saj ishin selvia dhe dafina, ndërsa pranë saj qëndronin Nimfat.

ARTEMIS

Roman Period, 2nd century A.D.. Marble.

The Goddess of hunting Artemis, wildlife, forests and cultivated fields, Apollo's sister is one of the most loved Gods in Apollonia. The Goddess is shown running, wearing a tunic up to the knee and holding the bow and arrows.



NEGATIV TERRAKOTE

Periudha Arkaike, fundi i shek. VI p.K.. Terrakotë.

Në periudhën arkaike fillon prodhimi i terrakotave me negativë. Terrakotat shërbenin si dhurata në tempuj ose në varre. Në fillim bëhej boceti dhe mbi të merrej negativ, nga i cili do të prodhoheshin në seri këto statueta. Terrakotat paraqisnin Perëndi të ndryshme apo krijesa mitologjike, kafshë, figura antropomorfe, lodra fëmijësh, njerëz etj..

TERRACOTTA MOLD

Archaic Period, end of 6th Century B.C. Terracota.

On the left is the mold and on the right is the figurine that has emerged as the final product. In earlier periods, figurines were made by hand, but from the end of the archaic period, molding began to be used.

Figurines are used as decorations, voting objects for temples or also for cemeteries. They generally represented gods, animals, banquet scenes or toys as well





STELË VARRI. GRUA ME VESHJE ILIRE

Periudha Helenistike, shek. II p.K.. Gur gëlqeror.

Objekti është një stelë varri, ku paraqitet një grua. Emri i shkruajtur sipër kokës nuk ruhet, por nga modeli i veshjes mendohet se ngjan me veshjen e grave Ilire. Këtë lloj veshje e ndeshim në shume stela varri dhe statuja që janë gjetur në qytete ilire. Kjo tregon se megjithëse Apolonia ishte një koloni, aty nuk mungoi elementi Ilir.

FUNERARY STELE

Hellenistic Period, 2nd Century B.C.. Limestone.

This object is a funerary stele, which from the dress and the cap is thought to be of an Illyrian. The inscription on the top of the tomb stone is damaged, and even that it is in ancient Greek language the Archaeologist thinks that the stele belonged to a Illyrian women.



LEKIT ME VERNIK TË ZI DHE FIGURA. HIDRIE ME VERNIK TË ZI DHE FIGURA TË KUQE

Shek. V p.K.. Qeramikë.

Këto enë shërbenin për vajin, ujin etj.. Zakonisht skenat e paraqitura në to janë të marra nga mitologjia. Ena pasi zhytej në solucionin e përgatitur më herët, lihej të thahej dhe mbi të pikturohej silueta e figurës. Enët janë import atikas dhe të gjetur në Apoloni.

LEKYTHOS AND HYDRIA WITH RED FIGURES

5th Century B.C.. Pottery.

Lekythoi are used for perfume and oil while Hydria is used principally for the water. The red figured pottery with mythological motifs were produced during Classical Period. These vases are imported from Attica, found in Apolonia.

KILIK ME VERNIK TË ZI (KUPË PËR PIRJEN E VERËS)

Periudha Klasike, shek. V-IV p.K.. Qeramikë.

Kilikët janë kupa, të cilat shërbenin për pirjen e verës gjatë banketeve të ndryshme. Ndër kilikët më elegantë janë ata me origjinë prodhimi atikase (zona e Athinës). Kilikët fillojnë të përdoren nga shekulli i VII deri në shek. III p.K..



KYLIX, BLACK PAINTED WITH METALLIC SHINING

Classical Period, 5th-4th Century B.C.. Pottery.

Kylix is used for drinking wine. The color makes the ceramic waterproof and also the imitation of the metal shine. This is an Attic imported kylix.

NIKJA QË SAKRIFIKON DEMIN

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Gur gëlqeror.


Nikja është Perëndesha e fitores, e bija e titanit Palas dhe nimfës Stige. Ajo nderohej në garat atletike, artistike, dhe fitoret në luftëra të ndryshme. Nikja ishte e lidhur ngushtësisht me Athinanë dhe paraqitet shpesh pranë saj me krahë dhe me trofe në artin antik grek. Në rastin tonë na jepet duke sakrifikuar një dem për nder të fitores. Mund të themi se ndoshta ka qenë pjesë e një frontoni të një tempulli.

NIKE, SACRIFICING THE BULL

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Limestone.

Nike is the Goddess of victory is represented with wings sacrificing the bull with a knife in her right hand and holding the bull's horn with her left. It may be part of a temple pediment.





HALLKOMA E BALAITËVE

215-200 B.C. Bronz.

Ky mbishkrim daton pas luftës së dytë Iliro-Romake (215-200 p.K.), kur romakët i shkrinë koinonet mes disa qyteteve. Objekti është një tabelë prej bronzi e gjetur në territorin e Balaitëve, ndoshta në qytetin antik që ndodhet në Gurëzezë, afër Cakranit. Në të dokumentohet nderimi që bylinët i bëjnë udhëheqësit të rojeve kufitare për punën e bërë. Ky objekt vjen nga territori i bylinëve, por vendi i saktë i gjetjes nuk dihet.

INSCRIPTION ON BRONZE PLAQUE KNOWN AS “HALLKOMA E BALAITËVE”

215-200 BC.. Bronze.

The inscription is in ancient Greek and is dedicated to the coronation in honorship of Peripolarc (military commander) Aristen Parmeni for his good deeds done to the Balaits (the local Illyrian population in the back lands to Apollonia).



STATUJË BRONZI E ZEUSIT

Shek. IV p.K.. Bronz.

Objekti është gjetur në Apoloni nga arkeologu Leon Rey, në akropolin e qytetit antik të Apolonisë. Si statujë ngjason me Zeusin e Dodonës. Njëra dorë e tij nuk ruhet, ndërsa tjetra ka patur në dorë rrufenë, armën e tij. Simbolet e Zeusit janë: rrufeja, demi, shqiponja, lisi.

BRONZE STATUE OF ZEUS

4th Century B.C.. Bronze.

Zeus is the God of the sky and the thunder, considered like the strongest and the king of the Gods of Olimp. Zeus with the head turned to the left is represented naked in hiting position with his right hand high ready to throw the thunderbold.

SIRENA VAJTUESE

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Gur gëlqeror.

Sirenat ishin krijesa mitologjike gjysmë njerëz, gjysmë zogj. Këto objekte vendoseshin në varre, pasi në antikitet mendohej se do të vajtojnë të vdekurit. Sipas mitologjisë ato dallonin për zërin e tyre, i cili hipnotizonte njerëzit.

MOURNING SIREN

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Limestone.

Mourning (wailing) siren are mythological creatures, half men and half bird. Usually they are used to decorate the grave stones in Hellenistic period.



PINCETA PER VETULLLAT

Periudha Romake, shek. II m.K.. Bronz.

Pincetat (njihen ndryshe edhe si piskatore) shërbenin për kurimin e vetullave nga gratë. Pincetat përdoreshin në periudhën Romake dhe ishin të realizuara në metal bronzi. Gratë i përdornin për përkujdesje estetike.

BRONZE TWEEZERS

Roman Period, 2nd Century A.D.. Bronze.

Tweezers are objects used for aesthetic care for the eyebrows, generally from aristocratic women.





RELIEV ME LEJLEKUN

Periudha Romake, shek. II m.K.. Mermer.

Shpesh herë artistët merrnin frymëzim nga natyra që i rrethonte edhe në këtë rast artistët e shkollës apoloniote të skulpturës kanë prodhuar një relief ku paraqitet një lejlek duke kapur një insekt.

RELIEF, REPRESENTING THE STORK CATCHING A GRASSHOPPER

Roman Period, 2nd century A.D.. Marble.

The school of the sculpture in Apolonia is well known for the carving of the reliefs using different motifs. Here we have a stork catching a grasshopper.

APLIKË BRONZI

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Bronz.

Aplikat janë objekte zbukurimi, të cilat përdoren duke iu mbivendosur një objekti tjetër më të madh për efekt dekorativ. Këto objekte prodhohen nga artizanë të specializuar në këto lloje punimesh. Materiali për prodhimin e tyre mund të ishte i ndryshëm, si metal (bronz, ar, argjend), brumë qelqi, kockë, etj.. Pasi prodhohen, ato vendosen në objektin për të cilin ishin krijuar, të cilët mund të ishin helmata, shpata, mburoja, enë të ndryshme metali, stoli etj.. Kryesisht me aplikat zbukuroheshin objektet e luksit.

BRONZE APPLIQUE DECORATED WITH PALM LEAVES

Hellenistic Period, 3rd Century B.C. Bronze.

Once produced they were fixed to other objects as decoration. This applique probably was part of a leather diadem.



AMFORË BRONZI

Shek. IV p.K.. Bronz.

Amforat zakonisht janë enë për transportin e verës ose të vajit të ullirit, por ka edhe amfora tavoline. Zakonisht janë prej qeramike, por kishte dhe raste kur ato prodhoheshin prej metali, si në rastin tonë prej bronzi. Amfora është me grykë të ngushtë, buzë me bordurë, bark i gjerë dhe me fund të sheshtë. Poshtë grykës janë të salduara dy vegje dhe në fund të tyre kemi disa zbukurime vertikale, ngjitja e të cilave bëhej me anë të nxehtësisë dhe me rrahje. Në anën e sipërme të vegjeve kemi të ngjitur dy unaza ku kapej një mbajtëse me një unazë sipër, e cila shërbente për tu kapur në një ganxhë, ku mund të vendosej mbi zjarr ose në një vend tjetër nga ku mund të shërbehej.

BRONZE AMPHORA

4th Century B.C. Bronze.

This is a table amphora with spheric body and flat end. Two handles are fixed under the mouth and the shoulders are decorated with palm leafs. A third decorated handle is fixed with the lateral handles by two rings; a third ring on top is used to hang the amphora. It is ceremonially used especially to serve the wine.



KOKË MERMERI NJË ARISTOKRATEJE ROMAKE

Periudha Romake, fundi i shek. I m.K.. Mermer.


Kjo është një kokë gruaje e punuar në mermer, dikur pjesë e një statuje. Mermeri mendohet se vjen nga Karrara, Itali. Koka daton në fundin e shekullit të I-rë mbas Krishtit. Zakonisht koka kishte cilësi më të mirë mermeri sesa trupi. Ky lloj modeli flokësh me kaçurrela, arrihej me anë të punimit me trapano, i cili fillon me dinastinë Flave (perandorët: Vespasian, Domician, Titus, 69-96 m. K.). Kjo teknikë të mundësonte krijimin e duhur të raportit dritë-hije edhe gjatë vështrimit të statujës nga larg.

FEMALE HEAD

Roman Period, 1st Century A.D.. Marble.

This object represent a aristocratic woman. The marble head was once part of a complete statue. The hair model shows the social status and the decoration is made with drills and resembles a wig.





MBUROJA E TIPIT ILIR

Shek. IV p.K.. Bronz, dru dhe lëkurë.

Ky është një nga objektet më unikë në Shqipëri. Mburopa u gjet gjatë viteve 80-të të shekullit XX në gërmimet e nekropolit të Apolonisë nga arkeologu Vangjel Dimo, në varrin e një ushtari hoplit (ushtar këmbësor i armatosur rëndë). Mburopa ka qenë prej druri dhe sipër saj ishte vendosur një fletë bronzi e punuar me motivet e rrathëve koncentrikë (rrathët koncentrikë simbolizonin diellin dhe rrezet e tij që përhapen) dhe në qendër është paraqitur Gorgona Meduzë me gjuhën e nxjerrë. Kur u gjet, mburoja ishte e copëzuar në 8153 copa dhe janë dashur mbi 20 vjet punë restauruese.

BRONZE SHIELD, KNOWN AS THE ILLYRIAN TYPE

4th Century B.C.. Bronze, wood, leather.

The Illyrian shield is represented in arts carved in stone or in the decoration of the bronze coins so this one is unique in Albania. The circles are symbol of the sun and in the middle the main decoration is the head of Medusa with snake hair and the tongue outside. This shield is excavated in the necropolis of Apollonia hardly corroded in thousand pieces, it took more than 20 years for the restoration.



MONEDHA ARGJENDI TË APOLONISË. STATERE ME PEGAS – HERAKLI (HERKULI)

Shek. IV p.K.. Argjend.

Apollonia fillon të presë monedhat e saj në mesin e shekullit IV para Krishtit. Monedha e parë që pret Apollonia ishte prej argjendi dhe kopjonte simbolet e metropolit, Korinthit nga kishin ardhur kolonistët e parë. Në një fazë të dytë me tridrahmet, apoloniatët do të kopjojnë prerjen monetare të Korkyrës (Korfuzit): lopa duke e pirë viçi; katrori i stilizuar (kopshiti i Alkinout) dhe mbishkrimi ΑΠΩΛ (ΑΠΩΛΛΩΝΙΑΤΑΝ – APOLONIATAN (e Apolonisë).

SILVER COINS OF APOLLONIA

4th Century B.C.. Silver.

Apollonia started to print her coins in silver in mid of 4th century B.C.. The first symbols were Pegasos-Hercules similar to the coins of Corinth and later the symbols were unified with the cities of Korfu and Durrahium: stylised rectangle (f) - the calf drinking from the cow (b), to distinguish the coins of Apollonia above the rectangle was the inscription ΑΠΩΛ (ΑΠΩΛΛΩΝΙΑΤΑΝ) – of Apollonia.

OJNOHE ME FIGURA TË KUQE

Shek- IV p.K.. Qeramikë.

Enët me figura të kuqe e kanë filluesën në fillim të shekullit V para Krishtit, në Atikë (zona e Athinës). Ojnoheja shërbente për të servirur verën gjatë banketeve dhe dallohet nga gryka në formën e tërfillit. Ky objekt ka të paraqitur në qendër një Amazonë, ku mbi kokë ka një helmetë dhe jepet duke vallëzuar me armët në duar, sopatën dytëhëshe dhe mburojën.

OINOCHAE, DECORATED IN RED FIGURES WITH THE DANCING AMAZON

4th Century B.C. Pottery.

The Amazon is wearing a helmet and holding her axe in the right hand while has the shield in the left one and is avoiding the attack with the spear horizontally represented. The vessel has spheric body; the mouth of the vessel has trefoil leaf shape as characteristic and is used to serve the wine. This is a local production.



STELË VARRI ME ARTEMISËN

Periudha Helenistike, shek. II p.K. Gur gëlqeror.


Artemisa është Perëndesha dhe Hyjnesha e gjuetisë, kafshëve të egra, pyjeve, fushave pjellore. Gjithashtu ajo ishte dhe perëndesha mbrojtëse e mureve rrethuese të qyteteve. Në qytetin e Apolonisë ishte një nga perënditë më të rëndësishme. Kjo duket në disa statuja të kushtuara si dhe tempulli në qendër të qytetit apo prerjet monetare me simbolin e saj.

FUNERARY STELE WITH ARTEMIS

Hellenistic Period, 2nd Century B.C.. Limestone.

Artemis is the Goddess of the hunt, wild animals, forests and cultivated fields. Here she is represented with the panther, a pouring cup in the right hand and the thyrsos in the left one, with curled hair and goat skin dress. The decorations make it looking like Dionysus, the God of wine.





ATLANTI (ATLASI)

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Gur gëlqeror.

Ky objekt është prodhuar nga mjeshtërit e skulpturës apoloniote, të njohur për shkollën e tyre të skulpturës. Skulptura shërbente si bazament kolone, ku anës saj kapeshin kangjellat e ballkonit të katit të dytë të një banese në mënyrë që ti jepte një pamje sa më madhështore hyrjes ose fasadës së banesës. Atlanti është gjetur në vitin 1958 gjatë gërmimeve shqiptaro-sovjetike në vilën me impluvium. Një kopje e tij gjendet në Luvër, pasi kanë qënë çift.

ATLAS

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Limestone.

Atlas, the strongest of the titans is represented suffering on holding the earth on his shoulders. The relief is reused in Roman Period as decoration of the house facade on the impluvium house fixed within the parapets line. Another copy is exposed at Louvre museum.



KRATER ME FIGURA TË KUQE. SKENË DIONISIAKE

Fundi i shek. IV p.K.. Qeramikë.

Krateri, prodhim apoloniote shërbente për të përzjerë verën me ujë dhe nuk ishte për përdorim të përditshëm, por vetëm në ceremoni festive. Zakonisht këto i përkisnin anëtarëve të shtresave të larta të shoqërisë. Në të dy anët e tij janë paraqitur dy skena me figura të kuqe; në të parën paraqitet Dionisi (Perëndia e verës dhe e teatrit) me dy aktore në krahë të tij. Kurse në anën tjetër paraqitet një Satir që po ndjek një Nimfë.

KRATER DECORATED WITH RED FIGURES

End of 4th Century B.C.. Pottery.

This vessel is local production and it is used to serve the wine in festive ceremonies. The decoration depicts Dionisos the god of wine and the theatre sitting on the throne surrounded by actors. In the upper part theatre masks are painted and floreal motives on the top and meandres on the bottom close the decorated scene.

SKENA E GJËTISË SË LUANIT

Periudha Helenistike, shek. I p.K.. Gur gëlqeror.

Ky objekt është pjesë frizi e fasadës kryesore të një ndërtese publike, ku paraqitet një kalorës mbi kalë duke gjuajtur, i cili mban një heshtë në dorën djathtë dhe është i rrethuar nga qentë. Poshtë saj kemi një kornizë të realizuar me motivin e meandrës, që në antikitet simbolizonte diellin në lëvizje. Ky element arkitektonik është gjetur gjatë restaurimit të kishës Fjetja e Shën Mërisë në Apoloni viti 1985.

THE SCENE OF HUNTING THE LION

Hellenistic Period, 1st Century B.C.. Limestone.

This is an architectural element, a frieze fragment worked in relief with hunting scenes. It depicts a hunter on horseback with a spear in his right hand, followed by hunting dogs hunting the lion, wild boar and the bull. The meanders that decorates the frame in antiquity symbolized the sun from sunrise to sunset. This relief represent the last elements of the influence of Alexander the Great on the arts.



FIGURINA TERRAKOTE

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Terrakotë.

Këtu janë paraqitur dy figurina terrakote të cilat përfaqësojnë një grua me veshje ilire dhe një burrë me tunikë të shek. III, të quajtur himation. Këto statueta prej balte të pjekur janë dedikime që bëheshin në antikitet si dhurata për perënditë e ndryshme në tempuj. Ato i vendosnin edhe në varret e familjarëve si dhurata apo i mbanin në shtëpi.

TERRACOTTA FIGURINES

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Terracotta.

The one on the left is representing a man wearing a himation, the figurine on the right representing a female in Illyrian dress. In general, the figurines were used as decorations, votive objects or idols so them could represent different figures such anthropomorphic, zoomorphic or Gods as well.





RELIEV QERAMIKE, EROSI DHE AFËRDITA

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Terrakotë.

Ky reliev përfaqëson Erosin dhe Afërditën, Perënditë greke të dashurisë fizike dhe të dëshirës, emri latin i të cilëve ishte Cupido (Kupidi) dhe Venera. Në art Erosi paraqitet me krahë si të engjëllit, lirën, harkun me shigjeta, delfinët, fyellin, trëndafilat dhe pishtarët. Në Apoloni, si kudo në botën antike adhurohej kulti i tij. Kjo dëshmohet në statujat kushtuar atij, gjithashtu në vazot e qeramikës të përdorura në ceremoni festive dhe përdorim të përditshëm.

RELIEF OF EROS AND APHRODITE IN TERRACOTTA

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Terracotta.

This object is the relief of Eros and Aphrodite, the Greek Gods of physical love and passion. Aphrodite is represented running over the sea waves and holding her hands with Eros, represented almost naked to the right of the relief..



MASKË GURI E TEATRIT

Periudha Helenistike, shek. III p.K.. Gur gëlqeror.

Maska ishte pjesë e frizit të skenës së teatrit, i cili dekorohet me triglife dhe metope. Në këtë rast kemi të bëjmë me një metope që vjen nga teatri. Në antikitet aktorët gjatë shfaqjeve të tyre në teatër, në momentin kur performonin tragjedi vendosnin maska me pamje tragjike, me një pamje si kjo maskë.

STONE THEATER MASK

Hellenistic Period, 3rd Century B.C.. Limestone.

This is a tragic mask, part of the frieze probably from the theatre. The relief is realized on limestone, carving the curled hair and the open mouth and big scared eyes. It is evident that the mask is not really used by actors but as decoration of the architectonical elements of the scene.

KANDILAT

Periudha Romake, shek. I-II m.K.. Qeramikë.

Kandilat në Apoloni fillojnë nga periudha e themelimit të qytetit deri në braktisjen e tij dhe përdorshin për ndriçim. Si lëndë djegëse përdorej vaji i ullirit. Kandilat më të stilizuara janë ata të periudhës Helenistike shekullit III-I para Krishtit, që përgjithsisht janë me ngjyrë të zezë, okër dhe të kuqerremtë. Në Apoloni ka shumëllojshmëri kandilash, si psh., ata që paraqesin dy gladiatorë duke luftuar apo një luan. Në qytetin antik të Bylisit kishte dy filiale të kompanisë FELIX dhe asaj FORTIS, të cilat prodhonin kandila me *terra sigilata* në Romë dhe Korinhtë.

OIL LAMPS

Roman Period, 1st-2nd Century A.D., Ceramic.

These lamps are of Roman Period, decorated with relief. The left one is decorated with gladiators fighting and the right one has a lion. The lamps were used to light the rooms but often we find them in the graves to light the way of the dead to the next world. The earlier lamps are black painted and many times are in metal.



LOTORE, ENË QELQI

Periudha Romake, shek. I m.K.. Qelq.

Objekti është gjetur nga gërmimet e bëra në nekropolin e periudhës Romake të qytetit antik të Apolonisë. Qelqi njihej që nga Egjipti i lashtë, por në pellgun e detit Mesdhe e bënë të njohur fenikasit. Në rastin tonë kemi: shishe, flakon dhe vazo të cilat përdorshin për vajrat, kremrat aromatikë; lotore, enë që mbledhnin lotët për ti vendosur bashkë me të vdekurin, në mënyrë që shprehte dhimbjen për personin e dashur.

GLASS BOTTLE, LACRIMATORY

Roman Period, 1st Century A.D.

The best-preserved glass objects have been excavated in the graves. The bottle is produced with the new Roman technique, the blowing glass. The glass is thin and decorated with thicker vertical stripes. In general, are used for perfumes, oils, but also used as lacrimatory.



#PrekeTrashëgiminë

Në kuadër të ruajtjes dhe vlerësimit të trashëgimisë kulturore materiale, si pjesë e rëndësishme e misionit të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), ka ekzistuar gjithmonë nevoja për dokumentimin e saktë të objekteve dhe siteve të trashëgimisë kulturore. Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore është një hap i domosdoshëm duke marrë në konsideratë zhvillimin e teknologjisë në botë, avantazhet që të jep dokumentimi në detaj, avantazhet në rritjen e aksesueshmërisë së informacionit, si dhe nevojën për të qenë në një linjë me të gjithë kuadrin ndërkombëtar të trashëgimisë kulturore.

IKTK-ja, në bashkëpunim me Zyrën e Administrimit Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni – Bylis, Muzeun Arkeologjik të Apolonisë dhe Universitetin Politeknik i Tiranës (UPT) – Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, në kuadër të projektit 3D-IMP-ACT, gjatë vitit 2020, realizoi aktivitetin: “Preke Trashëgiminë” - Produktet e projektit 3D-IMP-ACT në funksion të edukimit.

Në funksion të edukimit cilësor të moshave të reja, ndërgjegjësimit të komunitetit, si dhe në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara në shikim, aktiviteti pati për qëllim promovimin e trashëgimisë kulturore nëpërmjet përdorimit të teknologjive digjitale. Disa objekte të zbuluara në qytetin antik të Apollonisë dhe pjesë e koleksionit të MHK-së, u përzgjedhën dhe u skanuan nga ana e Departamentit të Prodhimit dhe Menaxhimit, UPT, për t'u riprodhuar në modele 3D. Tashmë këto modele të printuara në shkallë, gjenden të ekspozuara në Muzeun Arkeologjik të Apollonisë. Objektet mund të preken nga personat me aftësi të kufizuara në shikim. Në kuadër të projektit Muzeu i Apollonisë u pajis gjithashtu me përshkrime të objekteve të përzgjedhura, si dhe të gjithë vitrinave të Muzeut në alfabetin Brail.

#PrekeTrashëgiminë, ka për synim që të hapë një kornizë të re dhe një mënyrë të re të promovimit të trashëgimisë kulturore materiale për të gjithë ata që dëshirojnë të mund të njohin vlerat historike dhe artistike nëpërmjet shqisës së prekjës.

Marsela Plyku Demaj
Klodjana Gjata

#TouchingHeritage

In the framework of the preservation and assessment of tangible cultural heritage, which is an important part of the mission of the National Institute of Cultural Heritage (IKTK), there has always been a need for accurate documentation of cultural heritage sites and sites. The digitization of cultural heritage is a necessary step considering the development of technology in the world, the advantages provided from the detailed documentation, the advantages in increasing the accessibility towards information, as well as the need to be in line with the entire international framework of cultural heritage.

During 2020, IKTK, in cooperation with the Office of Coordination and Administration of the Archaeological Park of Apollonia - Bylis, the Museum of Apollonia and the Polytechnic University of Tirana (UPT) - Faculty of Mechanical Engineering, in the framework of the 3D-IMP-ACT project, implemented “Touching Heritage” - Products of the 3D-IMP-ACT project for the purpose of education.

Aiming at promoting quality education to young people, rising community awareness, as well as improving access to cultural heritage for people with visual

impairments, the activity promoted cultural heritage through the use of digital technologies. Some objects discovered in the ancient city of Apollonia and part of the collection of the National Historic Museum were selected and 3D scanned by the Department of Production and Management, UPT, to be reproduced in 3D models. These scale-printed models are already on display in the Archaeological Museum of Apollonia. The objects can be touched by visually impaired people. As part of the project, the Museum of Apollonia was also equipped with descriptions in Braille of selected objects as well as all the Museum's collection.

#TouchingHeritage, aims to open a new frame and to introduce a new way of promoting the tangible cultural heritage for all those who want to be able to recognize historical and artistic values through the sense of touch.





KOKË E "ARTEMISËS" (inv. 1259)

Mermer i bardhë. Lartësia 28,5 cm, gjerësia 18,5 cm, trashësia 24 cm

Apoloni, shek. IV p. Kr.

HEAD OF "ARTEMIS" (Inventory no. 1259)

White marble, Height 28.5 cm, width 18.5 cm, thickness 24 cm

Apollonia, 4th century BC



Kokë mermeri nga një statujë e Artemisë, e zbuluar gjatë punimeve restauruese në shkallaren e monumentit të Agonotetëve dhe me shumë gjasë ka shërbyer, së bashku me skulptura të tjera, si pjesë e dekorimit të harkut të triumfit të këtij monumenti. Shikimi ëndërrues, kthimi i qafës në të djathtë, mënyra e trajtimit të flokëve dhe lidhja e tyre sipër kokës, sugjeron një Apollon mjaft të ngjashëm me atë të Belvedere – s. Në fakt, ngjashmëritë midis dy hyjnive janë vënë gjithmonë në pah nga skulptorët e periudhës antike, pikërisht për të nënvizuar dhe përjetësuar lidhjen gjenetike midis dy hyjnive. Vepra përbën një nga ekzemplarët më të bukur të ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtar për nga mënyra e modelimit dhe teknika e punimit artistik. Punimi i kokës tregon se kemi të bëjmë me një vepër të artistëve lokal të influencuar nga qarqet artistike të shkollës së Praksitelit. Si e tillë ajo datohet në shek. IV p. Kr.

(Publikuar: K. ZHEKU, Skulptura të reja të zbuluara në Apoloni, *Buletin Arkeologjik*, Tiranë, 1971, f. 160 – 163; N. CEKA, SH. GJONGECAJ, S. DE MARIA, *Tesori del Patrimonio culturale Albanese*, nën drejtimin e A. Baçe, Roma, 2013, f. 64; *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar* [përgatitur nga D. Koçi, S. Bushi, A. Llukani], Tiranë, 2018, f. 16 – 17).

Marble head from one statue of Artemis, discovered during the restoration work at the Agonots monument staircase and most probably served, along with other sculptures, as decoration part of the triumphal arch of this monument. The dreamy look, the turn of the neck to the right, the way of treating the hair and their styling over the head, suggests an Apollon quite similar to that of the Belvedere. In fact, the similarities between the two deities are always emphasized by the sculptors of the ancient period, precisely to underline and perpetuate the genetic liaison between the two deities. The work represents one of the most beautiful specimens exhibited at the National Historic Museum, considering the way of modeling and artwork techniques. Head work shows that we are dealing with a work of local artists influenced by the artistic circles of Praksitel's school. As such it dates back to the 4th century BC



EROSI, PORTRET (inv. 1366)

Mermer. Lartësia 17 cm, gjerësia 14,5 cm, trashësia 15 cm

Apoloni, fundi i shek. III – fillimi i shek. II p. Kr.

EROS, PORTRAIT (Inventory no. 1366)

Marble. Height 17 cm, width 14.5 cm, thickness 15 cm

Apollonia, end of 3rd century – Beginning of 2nd century BC



Koka paraqet Erosin, me pamje fëmijërore. Karakteristikat e fytyrës spikasin për fytyrën e rrumbullakët, faqet e mbushura, sytë e mëdhenj dhe ballin e lartë, ndërsa hapija e gojës krijon përshtypjen e buzëqeshjes së lehtë. Flokët e pasur janë trajtuar me kaçurrela të bollshme dhe lidhen në pjesën e sipërme. Fizionomia dhe flokët tregojnë për një punim të kujdesshëm, i cili për nga karakteristikat që paraqet lidhet me punimet e erotëve të periudhës helenistike.

(Publikuar: *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar* [përgatitur nga D. Koçi, S. Bushi, A. Llukani], Tiranë, 2018, f. 22 – 23)

The head represents Eros, with infantile look. Facial features evidence a round face, clumsy cheeks, big eyes and high forehead, while mouth opening creates the impression of a light smile. Rich hair is treated with abundant curls and bonded to the upper front. Physiognomy and hair show a careful work, which by its characteristics relates to the works of the Hellenistic period of the erots.



FRONTON TEMPULLI (inv. 1228)

Gur gëlqeror. Lartësia 47,5 cm, gjerësia 0,65 cm, thellësia 21 cm
Apoloni, shek. II m.K.

TEMPLE FRONTON (Inventory no. 1228)

Limestone Height 47.5 cm, width 0.65 cm, thickness 21 cm
Apollonia, 2nd century AD.



Personifikim i lumit Aös në relief, i zbuluar nga H. Ceka në fshatin Paftal (Berat), e ka prejardhjen nga Apollonia. Hyji është përfytyruar si një plak i fuqishëm, i shtrirë dhe i mbështetur në krahun e djathtë. Fytyra e plakut është imponante, me mjekër dhe flokë të gjatë, që lëshohen mbi supet, të cilat artisti i ka paraqitur sikur janë të lagështa. Modelimi dhe teknika e punimit tregojnë për rëndësinë e paraqitjes së shumë detajeve anatomike. Identifikimi i figurës me personifikimin e lumit Aös, është mbështetur në elementë historikë, numizmatikë dhe mitologjikë. Lumi Aös kishte një rol të rëndësishëm në jetën ekonomike të Apolonisë. Personifikimi i Vjosës ndeshet dhe në monedhat e kohës perandorake të qytetit, çka përforcon më tepër adhurimin që bënte lumi. Nga ana tjetër edhe burimet e shkruara, si p. sh. Valter Maksimi, pohojnë rolin mbrojtës që i jepte Aosit në raste lufte.

(Publikuar: H. CEKA, S. ANAMALI, Disa skulptura të pabotueme të muzeumit arkeologjik-etnografik të Tiranës (Quelques sculptures inédites du Musée archéologique et ethnographique de Tirana), *BUSht; Seria Shkencat Shogërvore*, 3, 1959, f. 75 – 76; N. CEKA, Apollonia. *Historia dhe monumentet*, Tiranë, 2005, f. 21 – 23, fig. 9; *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar* [përgatitur nga D. Koçi, S. Bushi, A. Llukani], Tiranë, 2018, f. 28 – 29)

Personification of Aös river in relief, discovered by H. Ceka in the village of Paftal (Berat), originates from Apollonia. God is pictured as a powerful old man, stretched and laid on the right arm. The face of the old man is imposing, with long beard and hair, extended over the shoulders which the artist has represented as if they were wet. The modelling and the work technique shows the importance of portraying many anatomic details. The identification of the figure with the personification of river Aös, is supported by historical, numismatic and mythological elements. River Aös had an important role in the economical life of Apollonia. Vjosa personification is supported even by the imperial city coins of the time, which reinforces the adoration attributed to the River. On the other hand, the written sources, such as f. ex. Valter Maksimi, avow the defensive role given to Aös in cases of war.



RELIEVE ME NDESHJE GLADIATORËSH (inv. 1317)

Gur gëlqeror. Lartësia 58 cm, gjerësia 59 cm, trashësia 17 cm
Apoloni, shek. II m. Kr.

RELIEF WITH GLADIATORS FIGHT SCENE (Inventory no. 1317)

Limestone. Height 58 cm.
Apollonia, 2nd century AD



Relievi i gjetur në Apolloni në zonën e teatrit, është datuar në shek. II m. Kr. Ai mund të jetë dhe tregues i përdorimit të teatrit si arenë për ndeshje gladiatorësh. Dy protagonistët mbajnë veshje të njëjta luftarake, çka do të thotë që i përkasin të njëjtit grup gladiatorësh. Kështu, ata mbajnë një veshje të shkurtër rreth legenit me rrip prej lëkure, një galea (helmetë me fytyrë të mbuluar dhe dy të hapura për sytë, me një kreshhtë), gladius (lloj shpate e shkurtër), manicae (mbrojtëse të shpatullës) dhe greaves (lloj parzmorje për këmbët, e cila shtrihet nga kyçi i këmbës deri poshtë gjurit). Varianti i paraqitur duket mjaft i përpunuar dhe përshkruan përfundimin e një ndeshjeje midis dy gladiatorëve, ku fituesi pret qëndrimin e publikut ose funksionarit më të lartë për të autorizuar vendimin.

(Publikuar: N. CEKA, Apollonia. *Historia dhe monumentet*, Tiranë, 2005, f. 60, fig. 50)

The relief found in Apollonia in the theatre dates in 2nd century AD. The object might have been used as sign of theatre use as an arena for gladiators fights. Both men have same type of clothes. So, they wear a short cloth around belly with a leather belt, a galea (helmet that cover the face by leaving space for eyes to see and with a crest), gladius (type of a short sword), manicae (for protection of the shoulders) and greaves (type of legs shield, which protect the area from leg joint to under knee). This variant seems very elaborated and it describes the result of the match, where the winner is waiting the spectators or the highest functionary to decide it.



ATHINA PROMAHOS (inv. 1374)

Mermer. Skulptura: lartësia e 55 cm, gjerësia 24 cm, trashësia 16,5 cm.

Plinti: lartësia 16 cm, gjerësia 28 cm, trashësia 20,5 cm

Apoloni, shek. II m. Kr. (?)

ATHENS PROMAHOS (Inventory no. 1374)

Marble. Sculpture: height of 55 cm, width 24 cm, thickness 16.5 cm.

Plintb: height 16 cm, width 28 cm, thickness 20.5 cm

Apollonia, 2nd century AD (?)



Shtati i perëndeshës është zbuluar in situ në oborrin me peristil të banesës G dhe mendohet se qëndronte mbi stilobatin e tij. Skulptura e vogël është replikë e origjinalit të gjysmës së dytë të shek. V p. Kr., të Athina Promahos, vepër e skulptorit atikas Fidia. Perëndesha paraqitet si mbrojtëse, me armaturën e saj, në një qëndrim të qetë, e mbështetur në njëren këmbë ndërsa tjetra është lehtësisht e përkulur. Ajo mban të veshur tunikën e gjatë dhe me shumë gjasë në duart e saj mbante ndonjë prej atributëve të saj shoqëruese. Në pedestalin katërkëndësh të kësaj skulpture ruhet edhe nënshkrimi i mjeshtrit që e realizoi, Evemerit nga Athina (ΕΥΗΜΕΡΟΣ ΑΘΗΝΑΙΟΣ ΕΠΟΙΕΙ). Rëndësia e saj konsiston në faktin se është ndër të paktat vepra të ruajtura në muzetë shqiptarë që mban firmën e skulptorit.

(Publikuar: V. D. BILAVATSKI, S. ISLAMI, Gërmimet në Apolloni dhe Orik gjatë vitit 1958, *BUSbT, Seria Shkencat Shoqërore*, 1, 1960, f. 83 – 84, fig. 24; N. CEKA, *Apollonia. Historia dhe monumentet*, Tiranë, 2005, f. 60; *Thesare të Muzeut Historik Kombëtar* [përgatitur nga D. Koçi, S. Bushi, A. Llukani], Tiranë, 2018, f. 26 – 27).

The goddess's body was discovered in situ in the yard with peristyle of apartment G and was thought to stand on his stylobate. The small sculpture is a replica of the original of the second half of the 5th century AD, of Athens Promahos, the work of the atic sculptor Fidia. The Goddess appears as defensive, with its armour, in a relaxed position, standing on one leg while the other is easily bent. She is wearing a long tunic and most likely she is carrying in her hands any of her accompanying attributes. On the quadrilateral pedestal of this sculpture, the signature of the craftsman is noted to Evemere from Athens (ΕΥΗΜΕΡΟΣ ΑΘΗΝΑΙΟΣ ΕΠΟΙΕΙ). Its importance lies in the fact that it is among the few works preserved in Albanian museums holding the signature of the sculptor.



PORTRET I PERËNDISË SILEN (inv. 578)

Mermer. Lartësia 32,5 cm, gjerësia 21 cm, trashësia 26 cm

Apoloni, shek. III – II p. Kr.

PORTRAIT OF SILEN (Inventory no. 578)

Marble. Height 32.5 cm.

Apollonia, 2nd-3rd century BC



Portreti prej mermeri i Silenit është identifikuar fillimisht nga arkeologu austriak K. Paç, në muret e manastirit të Apolonisë. Paraqitjet e kësaj krijese mitike kanë qenë subjekt mjaft popullor në artin grek, pikërisht për shkak të lidhjes së tyre me Dionisin, si për sa i përket pjesës mitike ashtu edhe ritualit. Sileni paraqitet me flokë e mjekër të valëzuar, të cilat duken të shprishura dhe të shkujdesura. Fytyra është ovale, balli i rrudhosur, hunda e sheshtë dhe përgjithësisht kemi përpjekje të individualizimit të tipareve. Portreti mbart dëmtimet e kohës; hunda, mjekra dhe veshi i majtë paraqiten të dëmtuara. Paraqitja e përgjithshme e tipareve të fytyrës së portretit, përcaktojnë si datë të mundshme shek. III – II p. Kr.

(Publikuar: K. PATSCH, *Das Sandschak Berat in Albanien*, Wien 1904, kol. 153, fig. 118)

The marble portrait of Silen is identified for the first time from Austrian archaeologist C. Patsch in the walls of Apollonia's Monastery. Silen is worked with wavy hairs and beard, which are disheveled. The face is oval, the forehead is wrinkled, the nose is flat and in general there is a try for individualisation of the features. This features gives the possible date of 3rd-2nd century BC.



SHTATORE PERANDORI (inv. 1369)

*Mermer. Lartësia 208 cm, gjerësia 85 cm, trashësia 58,5 cm;
trashësia e plintit 11 cm.*

Apoloni, fundi i shek. III m. Kr.

STATUE OF AN EMPEROR (Inventory no. 1369)

Marble. Height 208 cm.

Apollonia, end of 3rd century AD



Shtatorja ka lartësi mbi realen, dhe është zbuluar në perëndim të buleterionit të Apolonisë. Burri paraqitet me një veshje të rëndë, me një togë të stilit perandorak, me një umbo në formë U – je, që është mjaft e zakonshme për periudhën augustiane. Palat e shumta të veshjes, janë në kontrast me pamjen e qetë të fytyrës. Sytë me beben e mbuluar përgjysmë nga qepallat dhe relievi i lartë i flokëve dhe mjekrës, e datojnë portretin në fundin e shek. III m. Kr. Përmasat e mëdha të skulpturës dhe ngjashmëria e fytyrës, sugjerojnë identifikimin me perandorin romak Komod, i cili sundoi midis viteve 180 – 192.

(Publikuar: V. D. BLLAVATSKI, S. ISLAMI, Gërmimet në Apolloni dhe Oriq gjatë vitit 1958, *BUSht*, *Seria Shkencat Shoqërore*, 1, 1960, Tab. XII dhe XIII; I. POJANI, Vështrim mbi koleksionin e skulpturave të Apolonisë të zbuluara nga Leon Rey, *Iliria* 31, 2003, f. 255, fig. 8; N. CEKA, *Apollonia. Historia dhe monumentet*, Tiranë, 2005, f. 91 – 92, fig. 78)

The dimensions of the statue are unreal and it discovered in the west of bouleuterion of Apollonia. The man has a long cloth, a toga of imperial style, with an umbo in a shape of U, which is usual in Augustan era. The half-closed eyes and the high relief of the hairs and beard are elements which dates the object at the end of 3rd century AD. The big size of the statue and the similarity of the face features suggest the identification with the Roman Emperor Commodus (180-192 AD).

Shënim: Kopjet e originalit nga Muzeu Historik Kombëtar janë realizuar në kuadër të projektit Interreg IPA 3D-IMP-ACT.

Note: Copy of the original from the National Historical Museum are produced within the project Interreg IPA 3D-IMP-ACT.

TË DHËNAT MBI BOTIMIN

Copyright:
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Parku Arkeologjik Apolloni
Tiranë 2020

Dizajni dhe faqosja:
Studio grafike petanidesign

Teksti i koleksionit të Muzeut Arkeologjik Apolloni:
Admir Xhelaj, Arjan Dimo
Fotografitë Muzeu Arkeologjik Apolloni:
Ornela Durmishaj

Teksti i koleksionit të Muzeut Historik Kombëtar:
Skënder Bushi
Fotografitë e koleksionit të Muzeut Historik Kombëtar:
MHK, Klodjana Gjata

Modelet e riprodhuara të Muzeut Historik Kombëtar:
Erald Piperi, UPT
Ilo Bodi, UPT

Redaktoi materialin dhe koordinoi realizimin:
Marsela Plyku Demaj, Klodjana Gjata, Renald Meta

Për më shumë informacion mbi 3D-IMP-ACT:
3dimpact.italy-albania-montenegro.eu

INFORMATION ON THE PUBLICATION

Copyright:
National Institute for Cultural Heritage
Archaeological Park of Apollonia
Tirana 2020

Design:
Studio grafike petanidesign

Text of the collection of the Archaeological Museum Apollonia:
Admir Xhelaj, Arjan Dimo
Photos Archaeological Museum Apollonia:
Ornela Durmishaj

Text of the collection of the National Historic Museum:
Skënder Bushi
Photos of the collection of the National Historic Museum:
MHK, Klodjana Gjata

3D models scanning and printing:
Erald Piperi, UPT
Ilo Bodi, UPT

Proof printing of the material and coordination:
Marsela Plyku Demaj, Klodjana Gjata, Renald Meta

For more information on 3D-IMP-ACT:
3dimpact.italy-albania-montenegro.eu



Interreg - IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro



PRIORITY AXIS

Smart management of natural and cultural heritage for the exploitation of cross border sustainable tourism and territorial attractiveness

SPECIFIC OBJECTIVE

Boost attractiveness of natural and cultural assets to improve a smart and sustainable economic development.

Interreg - IPA CBC
Italy - Albania - Montenegro



3D-IMP-ACT



Virtual reality and 3D experiences to **IMProve** territorial Attractiveness, Cultural heritage, smart management and Touristic development